



REPUBLIC OF KOSOVO
Lap: DPK/DMP
Dep: 03-1588/2012
No. Fillo: 02
Broj. Arme: 27-04-2012



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr. regj. 24883/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDRAVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupime pjesmarrjen e sekretares juridike Iqrame Aliu, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Avdullah Isufi nga fsh. Loshkobare/Ferizaj, për kundërvajtje nga neni 16 par 1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe të Dhuratave të Zyrtareve të lartë Publik Nr. 03/L-151, e në bazë të nenit 73,74,195 dhe nenit 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 29.12.2011 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Avdullah Misret Isufi, i lindur më 16.05.1958 në fsh. Lloshkobare/Ferizaj, ku edhe tani jeton, i martuar baba i dy fëmijeve, agronom-Keshillatr Politik Politik ne Ministrine e Bujqesise, i gjendjes mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse më 24.02.2011 si Keshillatr Politik i Zevendes Ministrit ne Ministrine e Bujqesise, ka pranuar formularin per Deklarimin e Pasurise dhe kete formular nuk ja ka derguar Agjencionit Antikorrupsion.

Me kete mos veprim, ka kryer kundërvajtje nga neni 16 par 1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe të Dhuratave të Zyrtareve të lartë Publik Nr. 03/L-151, andaj

G J O B I T E T

Me gjobë në shumën prej 400 (katerqindë) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në llogarine e të hyrave gjyqsore KGJK-se nr. 100-4300-700-0518. Pagesa bëhet në ndonjeren agjenci-Banke për mbledhjen e të hyrave, përmes urdherpagesës së plotesuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 26 ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqsor i pandehuri është i obliguar që të paguaj shumën prej 5 € në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën. Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencioni Kunder Korrupsionit në Prishtinë, parashtroj kërkesën nr. 01 3216/11 të dt. 12.07.2011, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj Avdullah Isufit, për kundërvajtjen nga neni 16 par 1.1 të Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe të Dhuratave të Zyrtareve të lartë Publik, duke kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjes dhe të dënohet sipas ligjit.


Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se si Keshillatr Politik i Zevendes Ministrit ne Ministrine e Bujqesise nuk ka qene i sigurte se deri kur do ta ushtroj kete pozite, duke pasur parasysh se postet politike emerohen dhe shkarkohen shpejt. Ka këkuar nga Gjykata ti merr parasysh të gjitha rrethanat letësuese dhe premtion se herave tejera do te jete shumë me i kujdeshem, duke shtuar se është i perkushtuar ti respektoj obligimet e dala nga Institucinet e Kosoves.

Në bazë të të dhënave të parashtruara në kërkesë, ndëgjimit të të pandehurit, shiqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtari në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë, për çka e shpalli fajtor dhe e gjobiti me gjobën e cekur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimi të denimit, gjyqtari vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit ia shqiptoi këtë lloj denimi, duke llogaritur se edhe me këtë do të arrihet

kërkesës Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në rishikim të arat prej 6 ditësh për miratim
nëpërmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

Gjyqtari
Lindita Jakupi



03-1588/2012/02.
Sergj